

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË SË VERIUT

PROPOZUES: Shërbimi profesional i Fondit

PËRGATITËS: Sektori për çështje financiare

RAPORTUES: Fatime Nexhipi, drejtoreshë e sektorit

PROPOZIM KËRKESË BUXHETORE
e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të
Maqedonisë së Veriut për vitin 2023

Në bazë të nenit 157 pika 3 të Ligjit të sigurimit pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.98/12, 166/12, 15/13, 53/13, 170/13, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14,20/15,61/15,97/15,129/15,147/15,154/15,173/15,217/15,13/16,27/16,120/16, 132/16, 35/18, 220/18, 245/18 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së 180/19, 275/19, 31/20, 67/20 dhe 67/22) dhe neni 33 paragrafi 2 nga Statuti i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr.174/2013), Këshilli drejtues i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 31.08.2020, përcaktoi

PROPOZIM KËRKESË BUXHETORE
të Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të
Maqedonisë së Veriut për vitin 2023

I. PJESA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Buxheti i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut për vitin 2023 përbëhet nga:

	denarë
I . Gjithsej të hyra	95.118.930.000
edhe atë:	
- të ardhura burimore dhe të tjera	63.060.450.000
- të ardhura nga transferimi	32.058.480.000
II. Gjithsej shpenzime	95.118.930.000
edhe atë:	
- qëllime të përcaktuara	95.118.930.000

Neni 2

Të ardhurat sipas burimeve dhe llojit të të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të qëllimeve kryesore përcaktohen edhe atë:

Balanci i të hyrave sipas zërit dhe dedikimit			87.598.000.000	95.118.930.000
Kategoria	Zëri	Përshkrimi	Rebalanci i Buxhetit të vitit 2022	Projektim Buxheti viti 2023
			3	3
71		TË ARDHURA BUXHETORE	57.131.500.000	62.840.450.000
71	712	Kontribute për sigurim social	55.636.500.000	61.270.700.000
71	714	Tatimet e vendit të mallrave dhe shërbimeve	1.495.000.000	1.569.750.000
72		TË HYRA TË PATATUARA	200.000.000	200.000.000
72	723	Taksa dhe kompensime	29.000.000	57.000.000
72	725	Të ardhura të tjera që nuk tatimohen	171.000.000	143.000.000
73		TË ARDHURA KAPITALE	10.000.000	10.000.000
	734	Të ardhura nga dividendat	10.000.000	10.000.000
74		TRANSFERTE DHE DONACIONE	30.246.500.000	32.058.480.000
74	741	Transferte nga nivelet të tjera të pushtetit	30.246.500.000	32.058.480.000
77		SHITJA E LETRAVE ME VLERË	10.000.000	10.000.000
77	771	Shitja e letrave me vlerë	10.000.000	10.000.000
Balanci i shpenzimeve sipas zërit dhe dedikimit			87.598.000.000	95.118.930.000
40		PAGA DHE KOMPENSIME	265.000.000	293.000.000
	401	Paga bazë	189.500.000	205.560.000
	402	kontribute për sigurim social	74.000.000	79.940.000
	404	Kompensime	1.500.000	7.500.000
42		MALLRA DHE SHËRBIME	169.685.000	152.000.000
	420	Shpenzime ditore dhe të rrugës	500.000	1.000.000
	421	Shërbimet komunale, ngrohja, komunikimi dhe transporti	56.235.000	61.500.000
	423	Materiale dhe Inventar i imët	15.000.000	15.050.000
	424	Riparime dhe mirëmbajtje rrjedhëse	37.800.000	29.300.000
	425	Shërbime kontraktuese	50.100.000	35.100.000
	426	Shpenzime të tjera rrjedhëse	10.050.000	10.050.000
	427	Punësime të përkohshme	0	
46		SUBVENCIONE DHE TRANSFERTA	10.315.000	10.000.000
	463	Transferta tek organizatat joqeveritare	2.000.000	2.000.000
	464	Transferta të ndryshme	7.989.000	8.000.000

	465	Pagesa për dokumente përmbarese	326.000	0
47		BENIFICIONE SOCIALE	87.103.000.000	94.601.930.000
	472	Pagesa e beneficioneve nga Fondi për SPIMV	87.103.000.000	94.601.930.000
48		SHPENZIME KAPITALE	50.000.000	62.000.000
	480	Blerja e pajisjeve dhe makinave	30.000.000	30.000.000
	481	Objekte ndërtimtare	20.000.000	30.000.000
	486	Blerja e automjeteve	0	2.000.000
II Pjesa e veçantë			87.598.000.000	95.118.930.000
1		ADMINISTRATA	479.000.000	501.000.000
10		ADMINISTRATA	479.000.000	501.000.000
40		Paga dhe kompensime	265.000.000	293.000.000
	401	Paga bazë	189.500.000	205.560.000
	402	Kontribute për sigurim social	74.000.000	79.940.000
	404	Kompensime	1.500.000	7.500.000
42		MALLRA DHE SHËRBIME	163.685.000	146.000.000
	420	Shpenzime ditore dhe të rrugës	500.000	1.000.000
	421	Shërbimet komunale, ngrohja, komunikimi dhe transporti	51.735.000	57.000.000
	423	Materiale dhe inventar i imët	14.950.000	15.000.000
	424	Riparime dhe mirëmbajtje investuese	36.500.000	28.000.000
	425	Shërbime kontraktuese	50.000.000	35.000.000
	426	Shpenzime të tjera rrjedhëse	10.000.000	10.000.000
	427	Punësime të përkohshme	0,00	0,00
46		SUBVENCIONE DHE TRANSFERTA	8.315.000	8.000.000
	464	Transferta të ndryshme	7.989.000	8.000.000
	465	Transferta për dokumente përmbarese	326.000	0
48		SHPENZIME KAPITALI	42.000.000	54.000.000
	480	Blerja e pajisjeve dhe makinave	30.000.000	30.000.000
	481	Objekte ndërtimtare	12.000.000	22.000.000
	486	Blerja e automjeteve	0,00	2.000.000
2		SIGURIMI PENSIONAL DHE INVALIDOR	87.103.000.000	94.601.930.000
20		SIGURIMI PENSIONAL DHE INVALIDOR	87.103.000.000	94.601.930.000
47		BENEFICIONE SOCIALE	87.103.000.000	94.601.930.000
46		Transferta të ndryshme	0	0
	464	Shpenzime për banjë dhe transport	0	0

	472	Pagesa e beneficioneve nga Fondi për SPIMV	87.103.000.000	94.601.930.000
3		VENDOSJE NË KONVIKT E FËMIJËVE ME PENGESA NË ZHVILLIMIN PSIKO-FIZIK	2.000.000	2.000.000
30		Vendosje në konvikt e fëmijëve me pengesa në zhvillimin psiko-fizik	2.000.000	2.000.000
46		SUBVENCIONE DHE TRANSFERTA	2.000.000	2.000.000
	463	Transferta tek organizatat joqeveritare	2.000.000	2.000.000
4		SHPENZIME PËR SHTËPITË PËR BANIM TË SHFRYTËZUESVE TË PENSIONIT	14.000.000	14.000.000
40		Shpenzime për shtëpitë për banim të shfrytëzuesve të pensionit	14.000.000	14.000.000
42		MALLRA DHE SHËRBIME	6.000.000	6.000.000
	421	Shërbimet komunale, ngrohja, komunikimi dhe transporti	4.500.000	4.500.000
	423	Materiale dhe Inventar i imët	50.000	50.000
	424	Riparime dhe mirëmbajtje rrjedhëse	1.300.000	1.300.000
	425	Shërbime kontraktuese	100.000	100.000
	426	Shpenzime të tjera rrjedhëse	50.000	50.000
48		SHPENZIME KAPITALI	8.000.000	8.000.000
	481	Objekte ndërtimtarie	8.000.000	8.000.000

Neni 3

Buxheti i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut për vitin 2023 do të zbatohet nga 1 janari i vitit 2023 me një harmonizim paraprak me Ministrinë e Financave dhe sjelljen nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02- 3943/1

31.08.2022

Shkup

**KRYETAR
I KËSHILLIT
DREJTUES,
Boro Varoshlija**

ARSYETIM
mbi Buxhetin e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor
të Maqedonisë së Veriut për vitin 2023

I. Pjesa e përgjithshme

Buxheti i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut për vitin 2023 paraqet plan vjetor të të hyrave dhe të dalave për realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor dhe kryerjen e papenguar dhe në kohë të qëllimeve dhe detyrave.

Buxheti paraqet një instrument me ndihmën e të cilit kryhet financimi i funksioneve të Fondit. I njëjti reflekton vazhdimësinë e zbatimit të aktiviteteve përmes një sigurimi të rregullt dhe në kohë të mjeteve nga kontributet dhe burimet e tjera të parashikuara me Ligjin për pagesën e rregullt dhe në kohë të pensioneve dhe të gjitha të drejtat e tjera dhe përmirësimin e standardit jetësor të shfrytëzuesve të pensionit dhe shfrytëzuesve të tjerë dhe ka një rëndësi të fuqishme ekonomike dhe sociale si pjesë e politikës ekonomike të Vendit.

Buxheti i Fondit të SPIMV-së për vitin 2023 është përgatitur pas qarkores buxhetore të marrë nga Ministria e Financave, në të cili-ën përmbahen udhëzimet kryesore për përgatitjen e Propozim – kërkesës buxhetore për këtë vit, në mbështetje të indikatorëve të mirëpritur makroekonomik për zhvillimin e Vendit në vitin 2023. Planifikimi i të hyrave dhe të dalave të Fondit, është marrë nga niveli i obligimeve të Fondit në vitin 2022 dhe obligimet e reja të pritura të Fondit në vitin 2023 që dalin nga zbatimi i sigurimit pensional dhe invalidor.

Proceset zhvillohen sipas rregullativës ligjore, Programit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, qëllimeve të përcaktuara të Fondit në Planin strategjik për periudhën 2023 – 2025 si dhe udhëzimeve të Këshillit drejtues të Fondit për qëllimet dhe detyrat me prioritet të cilat duhet të realizohen në punën e Fondit në vitin 2023.

Gjatë përgatitjes së Buxhetit të Fondit u morën edhe rekomandimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shpenzimin ekonomik dhe racional të mjeteve për të dalat aktuale me përkufizime ndaj të njëjtëve për vitin 2023.

Qëllimet prioritare në punën e Fondit në vitin 2023 janë:

- Sigurimi i mjeteve të nevojshme për pagesën e rregullt dhe në kohë të pensioneve dhe të drejtat e tjera që dalin nga sigurimi pensional dhe invalidor.
- Pagesa e rregullt dhe në kohë e mjeteve për fondin solidar për shfrytëzuesit e ndjerë të pensionit.
- Përmirësimi i sigurisë materiale dhe sociale i shfrytëzuesve të pensionit me harmonizimin e pensioneve, në mbështetje të dispozitave ligjore;
- Shpërndarja dhe kontrolli i vazhdueshëm, i saktë dhe në kohë i kontributeve ndërmjret Fondit dhe fondeve pensionale private dhe përfshierja e të siguruarve të rinj në përputhje me Ligjin.
- Marrjeja e rregullt dhe në kohë e të dhënave mbi kontributet e paguara nga Drejtoria e të Hyrave Publike për stazhin dhe pagat e të siguruarve në bazën e të dhënave të Fondit, për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor.
- Shërbimi cilësor dhe në kohë ndaj klientëve gjatë realizimit të të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor.
 - Pagesa e kontributeve të prapambetura, përfundimisht me vitin 2008 me ndërmarrjen e masave për pagesën e të njëjtave.
 - Aktivitetet e vazhdueshme në funksion të pengimit të realizimit të të drejtave dhe pagesës së pa bazë dhe të paligjshme dhe pagesa e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor.
 - Zbatimi konsistent i të gjitha dispozitave të Ligjit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut.
 - Përmirësimi i sistemit të informacionit si mbështetje teknike në zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor.
 - Përmirësimi i kushteve për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit në shtëpitë me të cilat ekonomizon Fondi.

Në vitin 2023, Fondi do të ndërmerr të gjitha aktivitetet e duhura për realizimin e qëllimeve prioritare dhe detyrave tjera që dalin nga Ligji i sigurimit pensional dhe invalidor, Statuti dhe aktet e tjera të Fondit si dhe obligimet nga Ligji i sigurimit pensional me financim kapital.

Supozimet themelore gjatë projektimit të Buxhetit të Fondit për vitin 2023 paraqiten në vijim:

a) Në pjesën e të hyrave

- zbatim-i i shkallës së kontributit për sigurim pensional dhe invalidor prej 18,8%,
- rritja e bruto pagave për 6,3 %;

- rritje e numrit të punësuarve për 3,6 %;

b) Në pjesën e të dalave:

- harmonizimi ligjor i pensioneve për 4,9 %
- fluksi i shfrytëzuesve të rinj të pensionit për 1%.

Në bazë të të hyrave dhe të dalave të realizuara të Fondit për periudhën janar – qershor dhe vlerësimet deri në fund të vitit 2022 si dhe supozimet e nënvizuara, projeksionet për Buxhetin e Fondit për vitin 2023 me të hyra dhe të dala të ribalancuara arrijnë shumën prej 95.118,93 milion denarë.

Për shkak të perceptimit të gjendjeve në realizimin e të hyrave dhe në kryerjen e obligimeve të Fondit edhe në vitin 2023, Shërbimi profesional i Fondit rregullisht do të monitorojë dhe analizojë gjendjen financiare gjatë tërë vitit dhe do ta informojë Këshillin drejtues të Fondit, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Financave dhe institucionet e tjera shtetërore më qëlim që, në kohë të duhur të ndëmerren masat mbi realizimin e pa penguar të funksioneve të Fondit.

II. Projeksionet e të hyrave dhe të dalave

Fondi në vitin 2023 do të realizojë funksionet në kuadër të gjithsej të dalave të planifikuara në shumë prej 95.118,93 milion denarë, që do të financohen nga të hyrat e vlerësuara në shumë prej 95.118,93 milion denarë.

Me projeksionet e të hyrave dhe të dalave të Fondit, deficiti në vitin 2023 është planifikuar në shumë prej 17.724,84 milion denarë.

Të hyrat dhe të dalat e Fondit sipas viteve arrijnë edhe atë:

Të hyra përkatësisht të dala	2019	2020	2021	2022- vlerësime	2023-plani
1. TË HYRA					

- Të hyra burimore	41,927.10	46,341.86	48,451.00	55.636,50	61,270.70
- Të hyra nga akcizat	1,378.61	1,334.88	1,400.00	1.495,00	1569.75
-Të hyra nga Buxheti i RM	28,098.22	29,852.40	30,626.00	30.246,50	32,058.48
- Të hyra tjera	4,472.58	142.81	150,00	200,00	200,00
- Të hyra nga dividendat	8.48	10.69	10,00	10,00	10,00
-Të hyra nga shitja e aksioneve dhe pjesëve	30.54	0,00	20,00	10,00	10,00
Gjithsej të hyra	75,915.53	77,682.64	80,657.00	87.598,00	95,118.93
2. TË DALA					
- Pensione	56,318.10	60,212.72	62,619.00	67.665,00	73,172.82
- Shpenzime transitive	8,861.58	8,612.15	9,300.00	10.559,00	11,818.64
- Kompensime nga sigurimi invalidor	91.56	89.53	100,00	83	100
- Kontribut nga sigurimi shëndetësor	7,437.42	7,881.72	8,140.00	8.796,00	9,512.47
-Paga dhe kompensime për të punësuarit	228.82	257.52	270.41	265,00	293
-Shpenzime për shërim në banjë dhe transport për pensionistët	11.81	0	32.59	0,00	0
- Të dala tjera	173.15	159.58	195,00	230,00	222
Gjithsej të dala	73,122.44	77,213.22	80,657.00	87.598,00	95,118.93
3. Tepricë e të hyrave përkatësisht të dalave	2,793.09	469.42	0,00	0,00	0,00

Në Buxhetin e Fondit si plan vjetor i të hyrave dhe dalave janë përfshirë të hyrat e planifikuara nga kontributet, nga mjetet e Buxhetit të Vendit, nga akcizat e derivateve të naftës, nga shitja e aksioneve dhe pjesëve dhe dividendës si dhe të hyra të tjera. Në pjesën e të dalave janë përfshirë të dalat për pensione dhe kompensime, kontributi për sigurim shëndetësor, shpenzime transitive, shpenzime për pagat e punonjësve, të dalat kapitale dhe shpenzime të tjera për zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor.

Të hyrat totale të Fondit janë planifikuar në shumë prej 95.118,93 milion denarë, në të cilën shumë pjesëmarrje më të madhe kanë të hyrat burimore të cilat përfaqësohen me 64,41% dhe mjetet nga Buxheti i Vendit me pjesëmarrje prej 33,70%.

Pjesëmarja e të hyrave burimore në gjithsej të hyrat është zmadhuar në 64,41% gjatë shkallës së kontributit prej 18,8% përderisa në vitin 2018 të njëjtat arrinin 55,17% gjatë shkallës së kontributit prej 18%.

Të hyrat në vitin 2023 janë planifikuar që të realizohen nga burimet në vijim:

-Mjete në bazë të kontributit në shumë prej 61.270,70 milion denarë, prej të cilave 11.818,64 milion denarë do të barten në fondet pensionale private për të punësuarit dhe anëtarët e rinj në sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital.

Në kuadër të këtyre të hyrave nga kontributi i pagave planifikohen mjete në shumë prej 59.093,20 milion denarë. Si bazë e planifikimit të këtyre të hyrave merren mjetet e planifikuara nga kontributet e pagës në Buxhetin e Fondit për vitin 2022 prej 53.724,50,00 milion denarë dhe rritja e pagave të të punësuarve prej 6,3%, rritja e punësimit në vitin 2023 prej 3,6%, si dhe rritja e shkallës së kontributit për SPI prej 18,8%.

- Nga Buxheti i Vendit, planifikohen mjete në shumë prej 32.058,48 milion denarë prej të cilave 2.000,00 milion denarë për mbulimin e pensioneve më të volitshme, ushtarake, pensioneve minimale bujqësore, 17.724,84 milion denarë për mbulimin e deficitit të Fondit, 11.818,64 milion denarë për mbulimin e shpenzimeve transitive dhe 515,00 milion denarë transfere nga Ministria e Mbrojtjes;

- nga akcizat e derivateve të naftës, mjetet në shumë prej 1.569,75 milion denarë;
- nga të hyrat e tjera mjete në shumë prej 200,00 milion denarë;
- nga të hyrat nga dividenda, mjete në shumë prej 10,00 milion denarë dhe
- nga shitja e aksioneve dhe pjesëve, mjete në shumë prej 10,00 milion denarë.

1. Të hyra nga kontributet

Të hyrat nga kontributet e Fondit sigurohen nga kontributet e pagës të të punësuarve, nga kontributet e të hyrave për stazhin e sigurimit i cili llogaritet me kohëzgjatje të shtuar (stazhi i beneficuar), kontributet nga pagat e personave fizik që kryejnë veprimtari të pavarur dhe të punësuarit tek ata, nga bujqit individual dhe kontribute nga Agjencia e Punësimit për kompensimin të cilin e paguan për personat përkohësisht të papunësuar. Sipas të gjitha këtyre bazave planifikohen të realizohen mjete, edhe atë:

a) **Të hyrat nga kontributet e pagave** për vitin 2023 planifikohen në shumë prej 59.093,20 milion denarë. Këta të hyra planifikohen në bazë të të hyrave të planifikuara

në Buxhetin e Fondit me projeksione - t deri në fund të vitit 2022 prej 53.724,50 milion denarë dhe të zmadhuara për rritjen e bruto pagave prej 6,3 % dhe rritjen e punësimeve për 3,6% që parashikohet të realizohet në vitin 2023 si dhe shkalla e kontributit për SPI prej 18,8%. Pjesëmarrja e kontributeve nga pagat planifikohet të arrijë 62,12% në raport me totalin e të hyrave.

Në vitin 2023 për fondet pensionale private planifikohet që të shpërndahen dhe barten mjete në shumë prej 11.818.64,00 milion denarë, të cilat Fondi në procedurë të vetme i mbledh sikurse për Fondin ashtu edhe për fondet pensionale private, ndërsa shpërndarja kryhet në bazë të numrit të të siguarve të anëtarësuar. Shkalla e kontributit për Shtyllën e dytë pensionale arrin 6% nga baza për pagesën e kontributit e përcaktuar me ligj. Në vitin 2022 planifikohet që numri i anëtarëve të arrijë rreth 577.089 anëtarë. Pikërisht, numri i të punësuarve në Shtyllën e parë reduktohet për shkak pensionimit të personave të cilët nuk janë të anëtarësuar në shoqëritë pensionale private, ndërsa numri i të siguarve në Shtyllën e dytë pensionale rritet për shkak të anëtarësimit të obligueshëm të personave të sapopunësuar.

b) Nga kontributi i të hyrave për stazhin e sigurimit i cili llogaritet me kohëzgjatje të shtuar planifikohen mjete në shumë prej 680,08 milion denarë. Këta të hyra janë rritur në raport të të hyrave të vlerësuara për vitin 2022 në bazë të rritjes së pagave dhe punësimit që planifikohet të realizohet në vitin 2023.

c) Nga personat fizik të cilët në mënyrë të pavarur kryejnë veprimtari dhe të punësuarit tek ata parashikohen mjete në shumë prej 1.303,86 milion denarë dhe të njëjtat pritet të rriten sikurse në periudhën paraprake.

ç) Të hyrat nga bujqit individual planifikohen që të realizohen në shumë prej 192,18 milion denarë dhe në krahasim me vlerësimet për vitin 2022 janë më të larta sepse çdo vit rritet interesi për regjistrimin dhe pagesën e kontributeve tek bujqit individual.

d) Të hyrat nga Agjencia e Punësimit planifikohen në shumë prej 1.39 milion denarë.

Në pjesën e realizimit të mjeteve nga kontributet, Fondi do t'i ndërmerr të gjitha masat e duhura ligjore për rritjen dhe sigurimin e pagesës më efikase të kontributeve që dalin nga legjislacioni, ndërsa do të vazhdojë edhe me ndërmarrjen e masave për pagesën e kontributeve të papaguara përfundimisht deri më 31.12.2008. Rregullisht do t'i ndjek të dhënat për kontributet e paguara nga DHP dhe do të kryejë shpërndarjen e mjeteve deri tek fondet pensionale private.

2. Të hyra nga Buxheti i Vendit

Të hyrat nga Buxheti i Vendit parashikohen në shumë prej 32.058,48 milion denarë edhe atë:

Për obligimet e rregullta – pensionet e realizuara nën kushte të volitshme, për pensionet ushtarake dhe pensionet minimale bujqësore, mjete në shumë prej 2.000,00 milion denarë; 17.724,84 milion denarë për mbulimin e deficitit rrjedhës; 11.818,64 milion denarë për shpenzimet transitive për të punësuarit të cilët janë **kyçur** apo do të **kyçen** në sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital; 515,00 milion denarë për mbulimin e pagesës së pensionit në përputhje me Ligjin për ARMV deri në plotësimin e kushteve sipas Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

Pjesëmarrja e të hyrave nga Buxheti i Vendit në gjithsej të hyrat e Fondit planifikohet të arrijë 33,70%.

Për realizimin e obligimeve të Buxhetit të Vendit ndaj Fondit, çdo muaj do të dorëzohet llogari me kuantifikim të obligimeve, sipas të gjitha bazave.

3. Të hyra nga akciza

Të hyrat nga akcizat të cilat llogariten sipas shkallës prej 9,18% nga akciza e shitjes së derivateve të naftës, planifikohen në shumë prej 1.569,75 milion denarë. Këta mjete planifikohen në bazë të mjeteve të vlerësuara në vitin 2022 dhe shkalla e planifikuar e rritjes së shpenzimeve të jetesës prej 5%. Të hyrat nga akcizat marrin pjesë me 1,65% në totalin e të hyrave të Fondit.

4. Të hyra nga dividenda dhe nga shitja e aksioneve dhe pjesëve të Fondit

Të hyrat nga dividenda dhe nga shitja e aksioneve dhe pjesëve të Fondit në vitin 2023 parashihen që të realizohen në shumë prej 20,00 milion denarë, edhe atë: nga dividenda 10,00 milion denarë dhe nga shitja e aksioneve dhe pjesëve 10,00 milion denarë.

5. Të hyra tjera

Në vitin 2023 në bazë të të hyrave të tjera parashikohet që të realizohen mjete në shumë prej 200,00 milion denarë. Këta të hyra kanë të bëjnë, edhe atë: me mjetet nga vende të tjera për mbulimin e pensioneve të shfrytëzuesve të pensionit të cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë, qiratë, të hyrat nga kompensimi i dëmeve, të hyrat nga pensionet e kthyer, dividenda nga banka komerciale dhe të tjera. Pjesëmarrja e këtyre mjeteve në totalin e të hyrave të Fondit arrin vetëm 0,21%.

III. Obligimet e Fondit

Të dalat totale të Fondit për vitin 2023 planifikohen në shumë prej 95.118,93 milion denarë. Me këta mjete planifikohet që të kryhet pagesë e rregullt e pensioneve për të gjithë shfrytëzuesit e pensionit si dhe për shfrytëzuesit e rinj të cilët të drejtën do ta realizojnë gjatë vitit 2023; bartja e kontributeve në llogaritë individuale të anëtarëve të fondeve pensionale private, pagesë të kontributit për sigurim shëndetësor të shfrytëzuesve të pensionit; pagesë e kompensimeve nga sigurimi invalidor, pagesë të pagës për punonjësit, shpenzime tjera për zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor.

1. Të dalat për pensione

Në vitin 2023, planifikohet që për pagesën e pensioneve të shpenzohen mjete në shumë prej 73.172,82 milion denarë apo 76,93% nga gjithsej të dalat, ndërsa së bashku me kontributin për sigurim shëndetësor (bruto pensione) pjesëmarrja arrin 86,93%. Këta të dala kanë të bëjnë me të gjitha llojet e pensioneve edhe atë: për pagesën e pensioneve të rregullta nga sigurimi i punës (pensionet e pleqërisë, invalidore dhe

familjare), pensioneve minimale bujqësore, pensionet ushtarake, pagesën e pensioneve jashtë vendit dhe për pagesën e pensioneve për shfrytëzuesit e rinj të pensionit të cilët të drejtën e pensionit do ta realizojnë në vitin 2023.

a) Të dalat për pagesën e pensioneve të rregullta në vitin 2023 parashikohen në shumë prej 72.877,24 milion denarë (nga e drejta e punës) edhe atë, për numrin ekzistues të shfrytëzuesve të pensionit dhe për numrin e ri të cilët do të realizojnë të drejtë në vitin 2023 si dhe për harmonizimin e rregullt të pensioneve prej 4,9% sipas harmonizimit të pensioneve sipas Ligjit të SPI.

Në vitin 2023 të dalat për pensione planifikohen që të rriten, edhe atë: në bazë të harmonizimit të pensioneve dhe në mbështetje me rritjen e planifikuar të pensionistëve të rinjë për vitin 2023 prej 1%.

Numri i shfrytëzuesve të pensionit parashikohet në fund të vitit 2022 të arrijë 341.827 shfrytëzues edhe atë:

Nr.R	Shfrytëzues	2022 (vlerësimi)	Struktura	2023 (planifikuar)	Struktura	Indeksi (4/2)
0	1	2	3	4	5	6
1	Pleqërie	231,235	67.65	236,246	68.43	102.17
2	Invalidor	31,106	9.10	29,986	8.69	96.40
3	Familjar	78,449	22.95	78,057	22.61	99.50
4	Ushtarak	982	0.29	913	0.26	92.97
5	Bujqësor	55	0.02	43	0.01	78.18
	Gjithsej	341,827	100.00	345,245	100.00	101.00

Në fund të vitit 2023 parashihet që, numri i shfrytëzuesve të pensionit të arrijë 345.245 shfrytëzues. Kjo është rritje prej 3.418 shfrytëzues, përkatësisht rritje për 1%. Nga ky numër planifikohet që 5.011 shfrytëzues të realizojnë të drejtën e pensionit të pleqërisë, përderisa të shfrytëzues tjerë parashikohet zvogëlim edhe atë: shfrytëzues të pensionit invalidor të zvogëlohen për 1.120, shfrytëzues të pensionit familjarë 392, shfrytëzues të pensionit ushtarak 69 dhe shfrytëzues të pensionit bujqësor më pak për 12. Edhe në vitin 2023 pritet që të vazhdojë rritja e numrit të shfrytëzuesve të pensionit

si rezultat i realizimit të të drejtës së pensionit vetëm me plotësimin e kufirit të moshës.

Gjithsej pensioni mesatar në dhjetor të vitit 2021 planifikohet që të arrijë një nivel mbi 17.198,00 denarë, apo për 4,95% më shumë në krahasim me dhjetorin e vitit 2022 (16.386,00). Ky është rezultat i planifikimit të harmonizimit të rregullt në mbështetje të Ligjit të SPI-së dhe pensioneve më të larta që i realizojnë pensionistët e rinj në raport të pensioneve më të ulëta të cilat i kanë shfrytëzuesit e ndjerë në periudhën e përlllogaritur.

b) Të dalat për pensionet minimale bujqësore janë planifikuar në shumë prej 5,34 milion denarë dhe të njëjtat reduktohen në raport të vitit 2022 si rezultat i deflukt natyror të këtyre shfrytëzuesve të pensionit.

c) Të dalat për pensionet ushtarake në vitin 2023 planifikohet që të arrijnë 290,24 milion denarë dhe të njëjtat janë zmadhuar në raport të vitit 2022 .

2. Shpenzimet transitive

Me Buxhetin e Fondit për vitin 2023 planifikohen 11.818,64 milion denarë mjete për kontribute deri tek fondet pensionale private në bazë të sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital. Këto mjete planifikohen në bazë të numrit të të siguruarve të anëtarësuar në fondet pensionale private në vitin 2022 dhe anëtarët e rinj të mirëpritur të cilët për herë të parë do të punësohen në vitin 2023 dhe të cilët në mbështetje të Ligjit të sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital i plotësojnë kushtet për antarësim në sigurimin e detyrueshëm..

Në fund të vitit 2022, numri i anëtarëve në fondet pensionale private vlerësohet se, do të arrijë rreth 577.089 anëtarë. Në vitin 2023 parashikohet rritje e punësimeve prej 3,6%. Me këtë shkallë pritet rritje e numrit të të sapopunësuarve të cilët detyrimisht do të **kyçen** në Shtyllën e dytë. Pas shpërndarjes së kryer të kontributeve ndërmjet Fondit dhe fondeve pensionale private, Fondi ka obligim ligjor që mjetet t'i paguajë në afat prej 8 ditësh.

3. Kompensim për dëmtim trupor

Në vitin 2023 për pagesën e kompensimit në të holla për dëmtim trupor planifikohen mjete në shumë prej 90 milion denarë dhe të njëjtat janë në nivel të mjeteve të vlerësuara nga viti 2022.

4. Kompensime nga sigurimi invalidor

Për pagesën e kompensimit në të holla në bazë të aftësisë së mbetur për punë nga sigurimi invalidor planifikohen mjete në shumë prej 8,00 milion denarë.

5. Të dala për vendosjen e fëmijëve në konvikt me aftësi të kufizuara në zhvillimin psiko - fizik

Për pagesën e mjeteve për vendosjen e fëmijëve në konvikt me aftësi të kufizuara në zhvillimin psiko – fizik planifikohen mjete në shumë prej 2,0 milion denarë. Këta mjete janë në nivel të mjeteve të vlerësuara nga viti 2022.

6. Kontributi për sigurim shëndetësor i shfrytëzuesve të pensionit

Në mbështetje të Ligjit të SPI, Fondi ka për obligim të paguajë kontribut shëndetësor për shfrytëzuesit e pensionit sipas neto shkallës prej 13% të pensionit të llogaritur. Për këtë qëllim me Buxhetin e Fondit për vitin 2023 planifikohen mjete në shumë prej 9.512,47 milion denarë. Këto mjete llogariten në shkallë prej 13% të shumës së pensionit. Pjesëmarrja e të dalave për sigurim shëndetësor në gjithsej të dalat arrin 10,00%.

7. Kompensimi i Shërbimit profesional të Fondit

Kompensimi i Shërbimit profesional të Fondit në vitin 2023 planifikohet në shumë prej 293,00 milion denarë për 603 të punësuar. Këta-o mjete janë paraparë në mbështetje me gjendjen aktuale të të punësuarve prej 531 dhe sipas ndryshimeve të sjella të Ligjit për marrëdhënie pune, gjatë të cilit do të largohen një numër më i madh i të punësuarve. Është planifikuar punësim i ri për 72 personave me arsim superior dhe të mesëm në mbështetje me nevojat e Fondit për kryerjen e detyrave të punës. Në Fond

shumë vite me radhë nuk janë bërë punësime të reja dhe numri arrin nivelin më të ulët i cili nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e rregullt të detyrave. Për shkak të defluksit natyror (pensionim) dhe arsyeve të tjera nga Fondi çdo vit largohet kuadro, ndërsa për shumë vite me radhë nuk janë pranuar kuadro të reja profesionale, kështu që obligimet e punës nuk mund të realizohen në kohë, gjë e cila kontribuon që aktvendimet të mos sillen në kohë dhe pensionistët e ardhshëm të presin më gjatë në sjelljen e aktvendimeve dhe pagesën e pensioneve, ndërsa nuk kanë të hyra tjera dhe as sigurim shëndetësor. Nga këto arsye Fondi planifikon që të kryhet punësimi i kuadrove të reja dhe janë paraparë mjete për të njëjtat. Të dalat për kompensim të Shërbimit profesional në gjithsej të dalat marrin pjesë vetëm me 0,31%.

8. Të dala të tjera

Shpenzimet për të dala të tjera planifikohen në shumë prej 160,00 milion denarë. Këto të dala kanë të bëjnë me shpenzimet për mirëmbajtje, shërbimet komunale, materialet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet për taksat gjyqësore dhe financimin e procedurave të falimentimit si dhe shpenzime të tjera për zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor. Pjesëmarrja e këtyre të dalave në totalin e të dalave të Fondit arrin 0,16%.

9. Shpenzimet kapitale

Në vitin 2023 për shpenzimet kapitale janë paraparë mjete në gjithsej shumë prej 62,00 milion denarë dhe të njëjtat kanë të bëjnë, edhe atë:

- 30,00 milion denarë për furnizimin e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve të tjera dhe
- 30,00 milion denarë për rikonstruimin e objekteve afariste (prej të cilave 22,00

milion denarë planifikohen për Qendër, filiale dhe ekspoziturat dhe 8,00 milion denarë për rikonstruimin e shtëpive për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit). Me këta-o mjete të parapara planifikohet të kryhet rikonstruimi dhe adaptimi i objekteve afariste të Fondit në Qendër, filialie dhe ekspozitua si dhe në shtëpitë e pensionistëve, kështu do të përmirësoheshin kushtet për punën e punonjësve dhe për përfituesit e pensionit.

- 2,00 milion denarë për furnizimin e automjeteve për shkak se Fondi disponon me automjeteve të cilëve vjetërsia e tyre në shumicën e rasteve arrin më shumë se 25 vjet prandaj shpenzimet për mirëmbajtje janë më të larta. Prandaj nevojitet furnizimi i automjeteve të reja për të cilat nuk do të ketë shumë shpenzime për mirëmbajtje dhe siguria në e të punësuarve të cilët i shfrytëzojnë ato nuk do të jetë e rrezikuar.

IV. Rezultate financiare

Me të dhënat mbi indikatorët makroekonomik për vitin 2023 dhe të dhënat e tjera për rritjen e shfrytëzuesve të pensionit, shkalla e kontributit të SPI-së, janë përlllogaritur të hyrat dhe të dalat e Fondit së bashku me mjetet e planifikuara nga Buxheti i Vendit parashikohet se Fondi në vitin 2023 do të realizojë të hyra dhe të dala të ribalancuara.

Me totalin e të hyrave të parapara me Buxhetin e Fondit për vitin 2023 në shumë prej 95.118,93 milion denarë, parashikohet që të sigurohet mbulimi i obligimeve të planifikuara të Fondit në shumë prej 95.118,93 milion denarë, përkatësisht pagesë e rregullt e pensioneve dhe të drejtat e tjera nga sigurimi pensional dhe invalidor në mbështetje të rregulativës ligjore si dhe shpenzimet e tjera që janë të domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë.

Për këtë qëllim, prioritet i veçantë në punën e Fondit edhe në vitin 2023 do të jetë ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve për realizimin e qëllimeve prioritare të Fondit, kontrolli i të dhënave nga pagesa e kontributeve, shfrytëzimi i qëllimtë i mjeteve të parapara në Buxhet, të punuarit racional dhe ekonomik si dhe zbatimi i rekomandimeve nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për një shpenzim ekonomik dhe racional të mjeteve për të dalat rrjedhëse.